



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:025142

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06524879

AC-I-24-0537

Në ankesën e

A H nga Fshati R- Obiliq.

Paditësi/ankuesi

Kundër:

NSH "Bujqesia"(në likuidim) e përfaqësuar nga Agjensia Kosovare e Privatizimit(AKP), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

E paditura

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV.-21-0218 të datës 12 qershor 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV.-21 -0218, i datës 12 qershor 2024, dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit, PRN009-0079 i datës 23 gusht 2013.**
- 3. Obligohet AKP-ja –Autoriteti i Likuidimit që ti paguaj paditësit në emër të pagave të pa paguara për periudhën mars 2007 deri në janar 2008 shumën prej 1,837.00 euro, interesin ligjor prej 10 % të shumës themelore në shumë prej 183.70 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në Procedurën e Likuidimit.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më datë 5 nëntor 2013, paditësi kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH-së KB "Bujqësia", e administruar nga AKP(AL i AKP-së) PRZ009-0079 të datës 23 gusht 2013. Me këtë vendim ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën kohore mars 2007 deri në janar 2008 në shumën prej 1.837,00 euro. Sipas paditësit/ankuesit, ky vendim është jo ligjor dhe i pa drejtë, gabimisht është konstatuar gjendja faktike dhe gabimisht është aplikuar e drejta materiale. Paditësi nuk pajtohet me konstatimin e AL të AKP-së se kërkesa është parashkruar, pasi që janë dorëzuar dëshmi të shumta në mbështetje të kërkesës së pretenduar.

Në përgjigjen e saj të datës 10 gusht 2018, AKP-ja e konsideron ankesën të pa bazuar dhe propozon që të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Më datë 22 dhjetor 2020 Shkalla e I-rë e DHPGJS-së kishte marrë Aktvendimin C-IV.-13-2840 me të cilin kërkesa ishte aprovuar si e bazuar, ishte shfuqizuar Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe çështja ishte dërguar tek Autoriteti i Likuidimit i AKP-së për rishqyrtim të kësaj kërkesë kreditore. Shkalla e I-rë konstatoi se paditësit marrdhënia e punës i është ndërprerë si pasojë e shitjes së NSH-së dhe si rezultat i vendimit të Agjencisë për privatizimin e NSH-së. Mu për këtë arsye, më 31 janar 2008 AKM ia kishte dërguar paditësit një njoftim me të cilin e informon paditësin se atij i është përfunduar marrdhënia e punës menjëherë dhe se borxhi për pagat e pa paguara do të shqyrtohet sipas prioriteteve të procedurave të likuidimit(pranim i borxhit). Shkalla e I-rë e DHPGJS-së vlerëson se është i pa pranueshëm pohimi i AKP-së se ankuesi nuk ka parashtruar fakte. Shkalla e I-rë gjithashtu konsideron se aplikimi i dispozitës së nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar ishte i gabuar, pasi që neni 366 i LMD-së përcakton se, "njohja me shkrim i detyrimit të parashkruar, konsiderohet heqje dorë nga parashkrimi". Andaj AKP obligohet që në rastin konkret lidhur me kërkesën kreditore të ankuesit të vendos në merita, e jo ta refuzoj si të pa vlefshme për shkak të parashkrimit.

Më datë 22 dhjetor 2020, kundër këtij aktvendimi ankesë ka parashtruar AKP për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të të drejtës materiale. AKP-ja pretendon se aktvendimi i kundërshtuar nuk është në përputhje me nenin 9.4.2 të Ligjit të DHPGJS-së. Një gjetje faktike e tillë nga Shkalla e parë është tërësisht jashtë kontekstit faktik të çështjes. AKP-ja nuk pajtohet me vlerësimin e Shkallës së parë të DHPGJS-së sa i përket parshkrimit, sepse ajo konsidëron se në ratsin konkret është fjala për parashkrim të kërkesës konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Sipas AKP-së, afati i parashtirimit ka të bëjë me meritat e të drejtës së pretenduar, duke e kundërshtuar edhe vlerësimin e Shkallës së parë kur vlerëson se kjo kërkesë duhej të gjykohej në meritat e saj. AKP e kundërshton edhe vlerësimin tjetër të gjykatës që ka të bëjë me Njoftimin për ndërprerje të marrdhënies së punës. Sipas AKP-së, ky njoftim është informim për parashtruesin se ai ka të drejtë të parashtrtoj kërkesë tek AL i AKP-së dhe kjo kërkesë në fakt është shqyrtuar nga AL i AKP-së, por është konsideruar se ajo kërkesë është parashkruar. AKP propozon që të aprovohet ankesa, të shfuqizohet aktvendimi i ankimuar, të gjykoj rastin mbi themelin e saj dhe të vërtetoj vendimin e AL të AKP-së.

Me datë 18 nëntor 2021, Kolegji i Apelit me Aktvendimit AC-I-20-0591, ankesën e AKP-së e aprovon si të bazuar, e anulon Aktvendimin e ankimuar dhe lëndën e dërgon në rigjykim në SHkallë të I-rë të DHPGJ-së tek gjyqtari përkatës. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se se aktvendimi i ankimuar nuk ka mbështetje ligjore për ta dërguar në rishqyrtim tek AL i AKP-së. Edhe pse në aktvendimin e ankimuar është përmendur se në bazë të nenit 74 paragrafi 4 të LDHPGJSK-së është vendosur si në dispozitiv, kjo nuk është arsyetuar në mënyrë të duhur. Nuk është arsyetuar se në bazë të cilës dispozitë mund të kthehet në rishqyrtim tek AL i AKP-së një kërkesë kreditore dhe në cilat kushte. Dispozita e lartë cituar e ennit 74.4 theksojnë se, "gjyqtari i vetëm apo kolegji mund të nxjerr një aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin dhe ndryshimin e vendimit të AL i AKP-së". Pra, askund nuk mund të gjendet një formulim që dërgon në një zgjidhje çfarë e kemi në këtë rast specifik, që do të thotë kthimin e një kërkesë te AL i AKP-së për rishqyrtim. Shkalla e parë ka mundur që ta vërtetoj, ta shfuqizoj dhe ndryshoj vendimin e AL të AKP-së, por jo ta kthej në shqyrtim tek AL i AKP-së. Kjo çasje e shkallës së parë nuk është e

qëndrueshme dhe e bazuar sepse është në kundërshtim edhe me praktikën e deritashme të Kolegjit të Apelit në rastin AC-I.-13-0233(Përmbledhje e Jurisprudencës të DHPGJSK-së- Vëllimi 1 2016). Kolegji i Apelit ka konsideruar se neni 74.4 i Shtojcës së LDHPGJSK-së përmban një listë shteruese të veprimeve dhe nuk lejon ta dëroj lëndën prapa tek AL i AKP-së për rishqyrtim. Shkalla e parë e DHPGJSK-së e kishte konstatuar se ishte obligim i AL të AKP-së që të vendos në merita, e jo ta refuzoj kërkesën si të pa vlefshme për shkak të parashkrimit. Kolegji i Apelit konsideron se pikërisht gjykata duhet të vendos vetë mbi meritat e ankesës dhe të vendos lidhur me kërkesën në fjalë, e jo ta kthej në rishqyrtim. Në këtë çështje specifike Shkalla e parë ka mundur që të vendos në merita duke u bazuar në provat dhe faktet e parashtuara, e jo për të njëjtën çështje që ka mundur të vendos, të kërkoj nga AL i AKP-së një veprim të tillë.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim ajo regjistrohet me numrin C-IV-21-0218.

Me datë 21 qershor 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJ-së ka lëshuar urdhër për paditësin mne të cilin ka kërkuar të dërgoj prova për ta mbështetur borxhin për paga të pa paguara të pretenduara ndaj NSH-së.

Me datë 12 korrik 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj urdhërit. Me këtë parashtresë ka dorëzuar listen e punëtorëve për paga për muajin shkurt 2007, një bilanc suksezi të NSH-së dhe njoftimin e AKM-së për nderprerje të mardhënies së punës me datë 31 janar 2008.

Me datë 12 qershor 2004, Shkalla e I-rë e DHPGJ-së me Aktgjykimin C-IV-21-0218 ankesën e paditësit e refuzon si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësi nuk ka ofruar dëshmi relevante që dëshmon se NSH-ja i ka mbetur borxh për pagat e kërkuara dhe nuk ka dorëzuar dëshmi mbi lartësinë e pagave të kërkuara për periudhën e cekur. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësi ka dështuar të dorëzoi prova relevante edhe pas urdhërit të lëshuar nga Gjykata. Andaj në mungesë të dëshmive nuk janë vërtetuar pretendimet e paditësit lidhur me pagat e kërkuara. Shkalla e I-rë konstaton se njoftimi për nderprerje të

mardhenies së punës nuk paraqesin dëshmi me të cilen vërtetohet obligimi i NSH-së për pagat e kërkuara për periudhën mars 2007 deri në janar 2008, andaj në bazë të nenit 40 të Shtojcës së Ligjit AKP-së paragrafi 1.6 pika 1.61 dhe 1.7 nuk gëzon të drejtë në paga të pretenduara ndaj NSH-së.

Me datë 09 korrik 2024, paditësi përmes postës e dërgon në DHPGJ-së një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-21-0218 të datës 12 qershor 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet kërkesa për kompensim të pagave të pa paguara si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së në rigjykim nuk merret me çështjen kryesore me parashkrimin e kërkesës, por merret me një çështje tjetër jashtë kontekstit të çështjes, diçka që nuk është kontestuese mes palëve. Tutje paditësi pohon se Aktgjykimi i ankimuar është konfuz, nuk përmban arsyet për faktet vendimtare dhe nuk përmend provat të cilat janë dorëzuar në gjykatë. Tutje ai pohon se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së nuk është marrë me çështjen kryesore, ndërprerjen e marrëdhënies së punës, përkatësisht me njoftimin në bazë të cilit paditësi ishte njoftuar se pagat e mbetura borxh në bazë të kontratës së punës me punëdhënësin mbeten për tu shqyrtuar në Procedurën e likuidimit. Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën për shkak të parashkrimit ndërsa gjykata nuk merret me parashkrimin e kërkesës tutje në ankesë paditësi i është referuar një numri të rasteve nga e njëjta NSH ku kërkesat janë aprovuar nga Kolegji i Apelit. Vendosija ndryshe e kësaj çështje nuk përkon me praktiken e konsoliduar të Kolegjit të Apelit. Paditësi pretendon se gabimisht janë aplikuar dispozitat materiale. Bashkë me këtë ankesë ai dorëzon dy Aktgjykime të Kolegjit të Apelit që i përkasin punëtorëve tjerë të së njëjtës NSH.

Me datë 26 gusht 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditëses si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për

mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjorë, andaj duhet të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 15 tetor 2010, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit, për kompensimin e pagave të pa paguara nga NSH "KB Bujqësia" (në likuidim), për periudhën nga data 01.03.2007 e deri 31.01.2008, në shumë prej 1,837.00 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit nuk i pranon si të sakta konstatimin e Autoritetit të Likuidimit dhe të Shkallës së I-rë, se kërkesa është parashkruar. E po ashtu nuk pranohet as konstatimi i Shkallës së I-rë se paditësi ka dështuar të dorëzojë prova relevante për ta mbështetur kërkesën e tij për paga për periudhën e cekur. Kjo për faktin se kërkesa për paga është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 15 tetor 2010, dhe ajo kërkesë i përket periudhës nga data 01.03.2007 e deri në 31.01.2008, që do të thotë nuk ka kaluar afati ligjor prej 3 viteve, për të ardhur në konstatimin se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi bashkë me ankesë ai ka dorëzuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN009-0079 të datës 23 gusht 2013. Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, një kopje të

bilancit të suksesit për ndërmarrjen, dhe një listë të pagave të punëtorëve të muajit shkurt 2007, në të cilën listë është edhe paditësi. Këto prova të ofruara nga paditësi, janë administruar nga ana e Gjykatës së Shkallës së I-rë, mirëpo nuk i ka konsideruar si të mjaftuara për ta aprovuar ankesën.

Paditësi e kishte pranuar Njoftimin nga AKM-ja për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, në kohën kur ende nuk kishte ndodhë parashkrimi, dhe duke u bazuar në këtë njoftim, pas fillimit të procedurës së likuidimit, ai me datë 15 tetor 2010 e paraqet kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit, në afat ligjor.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me listën e pagave të punëtorëve për muajin shkurt të vitit 2007, ai ka vërtetuar edhe lartësinë pagës së tij mujore. Por duke marrë për bazë këtë provë, si dhe faktin se AKP-ja shprehimisht në mbrojtjen në ankesë, nuk e ka kontestuar lartësinë e kompensimit të kërkuar në emër të pagave, por AKP-ja e konteston vetëm çështjen e parashkrimit, Kolegji i Apelit, bazuar në këto prova që i ka sjellë paditësi në gjykatë, e ka aprovuar padinë e paditësit si të bazuar, dhe e ka detyruar të paditurën që ti paguaj paditësit shumën prej 1,837.00 euro, në emër të pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.03.2007 e deri me 31.01.2008.

Duke u bazuar në nenin 37 par.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së paditësit përveç borxhit kryesor i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10 % të borxhit kryesor në shumë prej 183.70 euro, e cila shumë do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në Procedurën e Likuidimit.

Bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së, paditësit i është njohur edhe e drejta e kompensimit të shpenzimeve të përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208.00 euro, e cila shumë së bashku me borxhin e aprovuar për paga duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e aprovoi ankesën e AKP-së si të bazuar, e ndryshoj Aktgjykimin dhe e aprovoi padinë si të bazuar.

Numri i lëndës: 2023:025142
Datë: 29.11.2024
Numri i dokumentit: 06524879

Nga se u tha më sipër, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësor për procedurën ankimore me datë 26 korrik 2024 në shumë prej 20 euro andaj nuk do të caktohen taksa shtesë. Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 29 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues _____